



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
MINISTRIA E FINANCAVE**

**RAPORTI GJYSMËVJETOR PËR
REALIZIMIN E BUXHETIT TË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
SË VERIUT**

JANAR - QERSHOR VITI 2019

Shkup, korrik viti 2019

Përmbledhje

- Prodhimi bruto vendor në T1 të vitit 2019 në raport me tremujorin e njejtë të vitit 2018 shënoi rritje reale prej 4.1%, me ç'rast rritja e aktivitetit ekonomik vazhdoi me dinamikë të përshpejtuar;
- Numri i të punësuarve në T1 të vitit 2019 është më i lartë për 5.3% në bazë vjetore, me ç'rast rritje më të madhe të punësimit ka në industrinë e përpunimit. Shkalla e papunësisë në T1 të vitit 2019 u zvogëluar në 17.8%;
- Norma e inflacionit në gjysmëvjetorin e parë të vitit 2019 është 1.2%, si rezultat i rritjes së çmimeve të prodhimeve ushqimore dhe inflacionit bazik, ndonëse çmimet e energjensave shënuan rënie;
- Të ardhurat e përgjithshme buxhetore në periudhën janar - qershor u realizuan në vlerë prej 96.2 miliardë denarë, që paraqet 45.6% të vlerës së planifikuar për vitin 2019;
- Shpenzimet e përgjithshme buxhetore në periudhën janar - qershor u realizuan në vlerë prej 103.2 miliardë denarë, që paraqet 45.2 miliardë denarë të planit vjetor;
- Në periudhën janar - qershor të vitit 2019, deficitin buxhetor i RMV është 7.0 miliardë denarë, që paraqet pothuajse dy të pestat e deficitit të planifikuar, përkatësisht 1.0% të BPV-së së projektuar për vitin 2019;
- Borxhi shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut në fund të tremujorit të parë të vitit 2019 është 38.2% të BPV-së, ndërsa borxhi publik i cili e përfshin edhe borxhin e garantuar përbën 46.1% të BPV-së.

PËRMBAJTJA


Përmbledhje.....	1
1. Tendencat ekonomike ndërkombëtare.....	3
2. Tendencat makroekonomike në vend.....	4
2.1. Aktiviteti ekonomik.....	4
2.2. Tregu i fuqisë punëtore.....	6
2.3. Inflacioni dhe lëvizjet monetare.....	7
2.4. Bilanci i pagesave.....	8
3. Sektori fiskal.....	9
3.1. Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.....	9
3.1.1 Realizimi i Buxhetit themelor.....	11
3.1.2 Realizimi i buxhetit të fondeve.....	13
3.1.3 Realizimi i buxhetit të llogarive personale për të ardhura të shfrytëzuesve buxhetorë.....	14
3.1.4 Realizimi i Buxhetit të RMV sipas shfrytëzuesve buxhetorë.....	14
3.2. Menaxhimi me borxhin publik.....	16

1. Tendencat ekonomike ndërkombëtare¹

Rritja e aktivitetit ekonomik në BE në tremujorin e parë (T1) të vitit 2019 ishte 0.5% në bazë tremujore, përkatësisht 1.5% në bazë vjetore (Grafiku 1). Rritja ekonomike është nxitur nga kërkesa e brendshme dhe është reflektim i efekteve pozitive të disa faktorëve të përkohshëm, siç janë kushtet e volitshme të motit, nga të cilat përfitim kishte aktiviteti i ndërtimit, rritja e shitjes së automjeteve në eurozonë nga zhvillimet e pafavorshme në gjysmën e dytë të 2018, rritja e konsiderueshme e eksportit të mallrave në Mbretërinë e Bashkuar, i nxitur nga Bregziti eventual, si dhe masat e politikës fiskale që rritën të ardhurat e disponueshme të amvisërive në disa shtete anëtare.

Në tremujorët e ardhshëm, aktiviteti i ekonomisë evropiane do të kushtëzohet kryesisht nga rezistenca e sektorit të shërbimit dhe tregut të fuqisë punëtore duke pasur parasysh dobësitë në industrinë e përpunimit, rritjen e fuqishme ekonomike në Evropën qendrore dhe Evropën lindore, që është në kundërshtim me rritjen e ngadalhtë ekonomike në Gjermani dhe në Itali.

Grafiku 1. Rritja ekonomike vjetore në BE dhe në Gjermani (në %)



Rritja reale e BPV-së në BE është projektuar në 1.4% në vitin 2019, që paraqet një ngadalësim në krahasim me vitin 2018 kur rritja ishte 2.0%, ndërsa rritja e aktivitetit ekonomik në eurozonë pritet të ulet në 1.9% në vitin 2018 dhe në 1.2% në vitin 2019. Gjermania, si shtet anëtar me ekonominë më të madhe në BE dhe partner më i rëndësishëm tregtar i Maqedonisë së Veriut është parashikuar që të ketë rritje ekonomike prej 0.5% në vitin 2019.

Rritja e projektuar e ekonomisë evropiane është subjekt i rreziqeve që kryesisht janë në rënien. Njëkohësisht, çdo përshkallëzim i mëtejshëm i tensioneve tregtare dhe rritja e pasigurisë politike mund të vazhdojnë rënien aktuale të tregtisë globale dhe industrisë së përpunimit dhe të shkaktojnë shtrëngim të kushteve financiare globale. Burimi kryesor i pasigurisë në kuadër të BE-së edhe në vazhdim mbetet çështje e Bregzitetit.


¹ Analiza në këtë pjesë bazohet në Raportin veror të Komisionit Evropian - „European Economic Forecast – Summer 2019“, publikuar në korrik të vitit 2019.

2. Tendencat makroekonomike në vend²

2.1. Aktiviteti ekonomik

Prodhimi bruto vendor (PBV) në T1 të vitit 2019 në raport me tremujorin e njëjtë të vitit 2018 shënoi rritje reale prej 4.1%, me ç'rast rritja e aktivitetit ekonomik vazhdoi me një dinamikë të përshejtuar (Grafiku 2).


Grafiku 2. Rritja reale vjetore e BPV-së (në %)



Analizuar sipas veprimtarive, rritja ekonomike në T1 të vitit 2019 është rezultat i performancës pozitive të pothuajse të gjitha veprimtarive. Veprimtaria e ndërtimit u rrit me 7.0% në bazë reale, që sipas të dhënave me frekuencë të lartë për punët e përfunduara ndërtimore i detyrohet rritjes së aktivitetit ndërtimor në pjesën e ndërtimeve të ulëta, përkatësisht ndërtimit të rrugëve. Veprimtaria bujqësore pati rritje të madhe reale prej 13.6%. Rritja në sektorin industrial është 3.4% në bazë reale e nxitur fuqimisht nga rritja në industrinë e përpunimitit prej 3.5% (Grafiku 3). Të dhënat me frekuencë të lartë tregojnë vazhdimin e zhvillimeve pozitive në industri në muajin prill dhe maj, me ç'rast rritja e prodhimit industrial në periudhën janar - maj është 6.5%. Kontribut të rëndësishëm në rritje ka edhe prodhimi i makinerive dhe pajisjeve, aparateve elektrike, pijeve, prodhimeve dhe preparateve mjekësore, si dhe prodhimi i tekstileve dhe metaleve. Rritja në sektorin e shërbimit është 2.7%, kryesisht për shkak të rritjes së aktivitetit në tregti, transportit dhe hotelierisë prej 6.6%. Zhvillimet pozitive në veprimtarinë tregtare, sipas të dhënave me frekuencë të lartë, vazhduan me intensitet më të fuqishëm në muajin prill dhe maj, në kushte të rritjes së qarkullimit në të gjithë segmentet.


² Në raport janë përdorur të dhënat e fundit të disponueshme. Për BPV-në, të dhënat e papunësisë dhe të bilancit të pagesave janë përfshirë që nga tremujori i parë i vitit 2019.

Grafiku 3. Sektori i industrisë (shkalla vjetore e rritjes)



Analizuar sipas anës së shpenzimeve të BPV-së, rritja e aktivitetit ekonomik në T1 të vitit 2019 është rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme, me rritjen e konsumit dhe investimeve bruto. Konsumi shënoi rritje reale prej 2.1%, kryesisht si rezultat i konsumit privat i cili u rrit për 2.6%, që në pjesë më të madhe është si rezultat i rritjes së të ardhurave të disponueshme të amvisërive, në kushte të rritjes së punësimit dhe pagave në ekonomi. Konsumi privat u shoqërua gjithashtu nga rritja e kreditimit të amvisërive. Rritja reale e investimeve bruto vazhdoi me një intensitet të fuqishëm dhe arriti pothuajse në 10.0%, për shkak të rritjes së investimeve në ndërtim, shoqëruar edhe nga kreditimi më intensiv i sektorit korporativ.

Grafiku 4. Kontributi i komponentëve në rritjen vjetore të BPV-së (në pikë përqind)



Eksporti i mallrave dhe shërbimeve në T1 të vitit 2019 u rrit prej 15.6% në bazë reale kryesisht si reflektim i eksportit të kapaciteteve në zonat e lira ekonomike, shoqëruar edhe nga performancat solide të disa segmenteve të tjera të eksportit. Importi i mallrave dhe shërbimeve shënoi rritje reale prej 14.4%. Të dhënat mujore të këmbimit tregtar jashtë vendit në muajin prill dhe maj tregojnë për ruajtjen e rritjes së lartë të eksportit, që në këtë periudhë ishte 14.8% në bazë nominale, i nxitur nga rritja e eksportit të makinerive, pajisjeve të transportit, kimikateve, metaleve dhe prodhimeve ushqimore. Importi i mallrave në këtë periudhë u rrit për 14.1%, me ç'rast deficitin tregtar i mallrave në periudhën janar - maj paraqet 7.4% të BPV-së së projektuar dhe është në përputhje me pritjet.

Përshpejtimi i vazhdueshëm i rritjes gjatë vitit 2018, veçanërisht në tremujorin e fundit, shoqëruar me hyrjet e fuqishme të IHD-ve dhe rikuperimin e kërkesës për investime, si dhe zhvillimet pozitive në tremujorin e parë të vitit 2019 të shprehura përmes rritjes më intensive të prodhimit industrial dhe qarkullimit të tregtisë, mbajtja e aktivitetit të ndërtimit nga tremujori paraprak, rritja e vazhdueshme e fortë e aktivitetit të eksportit dhe kreditimi i përforcuar i sektorit privat ishin bazë për një rishikim të lehtë në ngritje të projeksonit për rritjen e aktivitetit ekonomik në vitin 2019 në 3.5% (nga 3.2% më parë). Zhvendosjet e tilla pozitive njihen gjithashtu edhe nga shumica e institucioneve ndërkombëtare, të cilët kanë kryer rishikim në rritje të projeksonit për rritjen ekonomike (Tabela 1).

Tabela 1. Krahasimi i projeksioneve për rritjen ekonomike dhe inflacionin për vitin 2019 (në%), projeksione të rishikuara dhe paraprake

Institucioni	Rritja reale e BPV-së (%)		Shkalla e inflacionit (%)	
	paraprake	e fundit	paraprake	e fundit
FMN	2.6	3.0	2.0	1.8
Banka botërore	2.9	2.9	2.0	1.8
Komisioni evropian	2.8	3.0	2.0	1.7
BERZH	3.0	3.0	/	/
Fiç Rejtings	3.2	3.4	/	/
Instituti i Vienës	3.0	3.1	2.0	2.0
BPRMV	3.5	3.5	2.0	1.5
Ministria e financave	3.2	3.5	2.0	2.0

Burimi: Fondi monetar ndërkombëtar (World Economic Database), Banka botërore (Western Balkans Regular Economic Report), Komisioni evropian (European Economic Forecast), Banka evropiane për rindërtim dhe zhvillim (Regional Economic Prospects), Instituti i Vienës (Forecast Report) dhe Banka popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (Raporti tremujor)


2.2. Tregu i fuqisë punëtore

Lëvizjet pozitive të tregut të punës në T1 2019 vazhduan me një dinamikë të fuqishme në krahasim me tremujorët paraprake (Grafiku 5). Sipas Anketës së fuqisë punëtore, shkalla e punësisë në T1 në vitin 2019 është 46.9% dhe në krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit 2018 është më e lartë për 2.3 pikë përqindje (p.p). Numri i personave të punësuar është më i lartë për 5.3%, përkatësisht për 39.5 mijë persona në krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar, me ç'rast rritje më të madhe të punësisë ka në industrinë e përpunimit, transportit dhe aktivitetet e informacionit dhe komunikimit. Analizuar nga statusi ekonomik, rritje të punësisë ka midis personave të punësuar (marrësit e pagave) dhe të vetëpunësuarit, ku punësimi u rrit me 9.0% dhe 1.4% respektivisht.

Rritja e punësisë shoqërohet me rënie të numrit të personave të papunësuar, i cili ra për 35.4 mijë persona, përkatësisht me 17.1% krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2018. Këto zhvillime shkaktuan që shkalla e papunësisë në T1 të vitit 2019 të binte në 17.8%, përkatësisht për 3.8 p.p. krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit 2018, ndërsa krahasuar me tremujorin paraprak, ajo ishte më e ulët për 1.6 p.p. (Grafiku 5). Vëzhguar sipas grupmoshave, shkalla e papunësisë u zvogëlua në të gjitha grupet dhe kjo ishte më e dukshme në grupmoshën 15-24 vjeç dhe shënon 37.0%.

Numri i popullsisë aktive u rrit për 4.1 mijë persona, përkatësisht për 0.4% në bazë vjetore. Popullsia aktive në T1 të vitit 2019 përbën 57.1% të popullsisë së përgjithshme të aftë për punë dhe është rrit për 0.2 p.p. krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit 2018.

Grafiku 5. Numri i të punësuarve dhe shkalla e papunësisë




Paga mesatare mujore neto në T1 të vitit 2019 shënoi rritje për 3.4%, ndërsa zhvillimet pozitive vijuan në muajin prill dhe maj, kur u regjistrua rritje nominale për 3.5% dhe 3.1%. Kështu, në periudhën janar - maj të vitit 2019, paga mesatare neto ishte më e lartë për 3.4% në bazë nominale dhe 1.9% në bazë reale, që paraqet mbajtjen e rritjes së pagës në nivel solid, për shkak të rritjes të pagave në pothuajse të gjitha aktivitetet.

2.3. Inflacioni dhe lëvizjet monetare

Shkalla e inflacionit në gjysmëvjetorin e vitit 2019 është 1.2%, që është nën pritshmëritë. Rritja e çmimeve konsumatore në gjysmën e parë të vitit është si rezultat i rritjes së çmimeve të prodhimeve ushqimore (2.4%) dhe inflacionit bazik³ (0.9%), ndërsa çmimet e energencave shënuan rënie. Dinamika tremujore tregoi rritje të balancuar të çmimeve në të dy tremujorët në gjysmën e parë të vitit (Grafiku 6).

Grafiku 6. Shkalla vjetore e inflacionit (në %)



Në muajin mars të vitit 2019, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut uli bazën e normës së interesit nga 2.5% në 2.25%, që është një reflektim i inflacionit të matur dhe lëvizjeve të

³ Infacioni pa komponentin ushqimor dhe energjik.


vazhdueshme të favorshme të tregut devizor, nga mungesa e presioneve të sektorit të jashtëm dhe perceptimeve stabile të subjekteve vendore.

Zhvillimet pozitive sa i përket depozitave dhe kredive vazhduan në gjysmën e parë të vitit 2019. Depozitat e përgjithshme në sistemin bankar në muajin qershor të vitit 2019 janë më të larta për 10.5% në bazë vjetore, kryesisht për shkak të rritjes së depozitave në valutën vendore, të cilat u rritën për 14.0%. Aktiviteti kreditor në muajin qershor të vitit 2019 vazhdoi me dinamikë solide, përkatësisht rritja kreditore shënon 8.1% në bazë vjetore, në kushte të kreditimit intensiv të ndërmarrjeve (ritje prej 6.4%) dhe kreditimit stabil të amvisërive (ritje pothuajse me 10.0%).

2.4. Bilanci i pagesave

Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave në T1 2019 ka saldo negative në vlerë 162 milionë euro, kryesisht për shkak të deficitit tregtar, me afro 70% të tij mbulohet nga saldoja pozitive të llogarisë së të ardhurave dytësore (transferet neto nga jashtë vendit), siç shihet në Grafikon 7. Në krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit 2018, deficitin e llogarisë rrjedhëse zgjerohet në mënyrë të caktuar, kryesisht si rezultat i përkeqësimit të saldosit tek shkëmbimi i mallrave dhe shërbimeve. Në periudhën e ardhshme, në kushte të rritjes së parashikuar të fluksit të hyrjeve të transfereve private nga jashtë, pritet performancë më të favorshme në saldon e llogarisë rrjedhëse.

Grafiku 7. Lëvizjet në bilancin e pagesave (në milionë euro)



Investimet e huaja direkte (IHD) në vend janë 29.7 milionë euro në T1 të vitit 2019, pas investimeve të fuqishme të regjistruar vitin e kaluar. IHD në këtë periudhë ishte në formën e kapitalit individual dhe ri-investimit të fitimit, mbi bazën e të cilave u regjistruan fluk të hyrjeve prej 173 milionë euro, ndërsa transaksionet ndërmjet kompanive kishin ndikim negativ tek fluksi i hyrjeve të përgjithshëm të IHD.


Në fund të muajit qershor të vitit 2019, rezervat devizore arritën në 2.9 miliardë euro dhe u rritën për 2.1% krahasuar me fundin e vitit 2018. Rezervat devizore në fund të muajit qershor sigurojnë mbulim mujor prej 4.4 të importit të mallrave dhe shërbimeve nga periudha e kaluar, që është nivel adekuat i rezervave për të përballuar goditjet e mundshme.

3. Sektori fiskal

3.1. Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Me Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2019 janë planifikuar të ardhura të përgjithshme në vlerë prej 210.848 milionë denarë, shpenzime të përgjithshme në vlerë prej 228.548 milionë denarë, përkatësisht është planifikuar deficit prej 17.700 milionë denarë (deficiti i Buxhetit themelor prej 13.479 milionë denarë, deficiti i fondeve prej 379 milionë denarë dhe deficiti i llogarisë për të ardhura vetanake prej 3.842 milionë denarë).

Grafiku 8. Paraqitja skematike e Buxhetit të RMV-së, realizimi (në milionë denarë) dhe shkalla e realizimit (në %) në gjysmëvjetorin e parë të vitit 2019



Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit janë realizuar në vlerë prej 96.211 milionë denarë, që është 45.6% nga vlera e planifikuar për vitin 2019, përkatësisht rritje prej 6.1% në raport të të ardhurave buxhetore të realizuara në periudhën e njëjtë të vitit 2018 (Tabela 2). Në kuadër të të ardhurave të përgjithshme, 84.559 milionë denarë janë realizuar në bazë të të ardhurave tatimore dhe kontributeve sociale, me ç'rast shkalla e realizimit është 45.9% nga vlera e planifikuar për vitin 2019, përkatësisht është hasur rritje prej 2.6% në raport me vitin paraprak. Përveç kësaj, të ardhurat tatimore janë realizuar në vlerë të përgjithshme prej 55.140 milionë denarë⁴ (përkatësisht realizim prej 45.2% të vlerës së planifikuar për vitin 2019), derisa kontributet janë realizuar në vlerë prej 29.419 milionë denarë (rritje reale prej 9.0%, përkatësisht 47.2 të vlerës së planifikuar për vitin 2019). Në kuadër të të ardhurave tatimore, rritja reale kishte tek tatimi mbi të ardhurat personale prej 16.0%, tek detyrimet e importit prej 2.7% dhe tek akcizat prej 1.6%. Të ardhurat e TVSH-së mbeten të pandryshueshme, ndërsa zvogëlim ka tek tatimi mbi fitimin prej 20.5%.

Shpenzimet e përgjithshme të Buxhetit të RMV-së në periudhën janar - qershor të vitit 2019 janë realizuar në vlerë prej 103.242 milionë denarë, që është 45.2% të planit vjetor, përkatësisht rritje prej 8.5% në raport prej gjysmëvjetorit të parë të vitit 2018. Përveç kësaj, shpenzimet rrjedhëse janë realizuar në vlerë prej 97.963 milionë denarë, përkatësisht 48.4% të vlerës së planifikuar për të gjithë vitin, që paraqet rritje prej 7.5% në raport të periudhës së njëjtë të vitit 2018, kryesisht si rezultat i transfereve të mëdha për 6.9% (rritje prej 8.5% të transfereve për pensione, shtesës sociale dhe mbrojtjes shëndetësore dhe rritje prej 5.4% të transfereve për TVSH-në, bllok dotacione dhe të dedikuara), si dhe realizim më i lartë për kategoritë: mallra dhe shërbime për

⁴ Të përfshira janë të ardhurat e llogarive personale prej 677 milionë denarë.

14.0%, shpenzime interesi për 23.8% dhe paga dhe kompensime për 4.4%. Shpenzimet kapitale janë realizuar në vlerë prej 5.279 milionë denarë dhe janë më të larta për 31.3% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2018. Shkalla e realizimit të shpenzimeve kapitale në gjysmëvjetorin e parë është zakonisht më e ulët, përkatësisht është 20.3% në vitin 2019, me atë që në gjysmën e dytë pritet të përshejtojë realizimi i këtyre shpenzimeve.

Tabela 2. Realizimi i Buxhetit të RMV-së për periudhën janar - qershor të vitit 2019

	Buxheti 2019	janar-qershor 2019			jan.-qer. 2013-2018	jan.-dhjet. 2013-2018
	milionë denarë	milionë denarë	shkalla vjetore e rritjes	shkalla e realizimit	shkalla mesatare e realizimit (në raport me buxhetin fillestar)	
TË ARDHURAT E PËRGJITHSHME	210.848	96.211	6,1%	45,6%	45,8%	95,7%
Tatime dhe kontribute	184.201	84.559	2,6%	45,9%	47,6%	98,9%
Tatime	120.166	54.463	-0,4%	45,3%	47,6%	98,4%
Tatimi mbi të ardhurat personale	19.083	8.702	16,0%	45,6%	48,6%	105,4%
Tatimi mbi fitimin	15.301	6.535	-20,5%	42,7%	76,3%	128,5%
TVSH	52.136	24.068	0,0%	46,2%	44,5%	92,5%
Akciza	27.280	12.037	1,6%	44,1%	48,3%	107,0%
Detyrimet e importit	5.816	2.855	2,7%	49,1%	49,0%	100,2%
Të ardhura tjera tatimore	550	266	9,0%	48,4%	27,9%	55,1%
Kontribute	62.316	29.419	9,0%	47,2%	47,9%	100,2%
Të ardhura jotatimore	18.521	9.374	57,9%	50,6%	35,0%	75,4%
Të ardhura kapitale	2.026	395	-51,3%	19,5%	36,2%	69,9%
Donacione të jashtme	6.000	1.883	32,6%	31,4%	36,9%	99,5%
Të ardhura nga huatë e arkëtuara	100	0	-100,0%	0,0%	30,8%	67,1%
SHPENZIME TË PËRGJITHSHME	228.548	103.242	8,5%	45,2%	46,6%	95,9%
Shpenzime rrjedhëse	202.577	97.963	7,5%	48,4%	48,7%	98,8%
Paga dhe kompensime	28.388	13.637	4,4%	48,0%	48,9%	98,5%
Mallra dhe shërbime	19.643	7.774	14,0%	39,6%	40,8%	84,7%
Transfere	145.366	73.824	6,9%	50,8%	50,5%	100,7%
Transfere sociale	107.675	53.591	8,5%	49,8%	49,7%	101,0%
SPIMV	64.614	32.862	9,1%	50,9%	50,1%	101,4%
Kompensim financiar për të papunësuarit	2.241	1.055	28,0%	47,1%	40,3%	89,0%
Ndihma sociale	10.607	4.490	7,7%	42,3%	49,5%	101,7%
Mbrojtja shëndetësore	30.213	15.184	6,2%	50,3%	49,7%	100,9%
Transfere të tjera	35.565	19.512	2,9%	54,9%	53,0%	100,0%
Pagesa të interesit	9.180	2.728	23,8%	29,7%	40,4%	108,8%
Shpenzime kapitale	25.971	5.279	31,3%	20,3%	31,6%	74,4%
SALDOJA BUXHETORE	-17.700	-7.031	54,9%	39,7%	52,7%	95,6%

Burimi: Ministria e financave

Në periudhën janar - qershor të vitit 2019 është realizuar deficit në Buxhetin e RMV-së në vlerë prej 7.031 milionë denarë (Tabela 2), që është 1.0% të BPV-së së projektuar për vitin 2019. Në kuadër të Buxhetit të RMV-së, Buxheti themelor ka realizuar deficit prej 7.810 milionë denarë, fondet kanë realizuar suficit prej 302 milionë denarë, ndërsa llogaritë për të ardhura personale realizuan suficit në vlerë prej 477 milionë denarë.

Duke pasur parasysh realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të Buxhetit të RMV-së në gjysmën e parë të vitit, janë të mundshme disa devijime në rënie në lidhje me vlerat e projektuara gjatë gjithë vitit 2019, të cilat megjithatë nuk do të kishin reflektim negativ në deficit. Më saktësisht, deficitin e Buxhetit të RMV-së gjatë gjithë vitit 2019 është projektuar në 2.5% të BPV-së.


3.1.1 Realizimi i Buxhetit themelor

Të ardhurat e përgjithshme të Buxhetit themelor në periudhën janar - qershor të vitit 2019 janë 56.614 milionë denarë dhe të njejtat paraqesin 45.0% të të ardhurave të përgjithshme të parashikuara për vitin 2019 në vlerë prej 125.895 milionë denarë.

Arkëtimi i të ardhurave tatimore, të cilat paraqesin zërin buxhetor më të rëndësishëm në kuadër të të ardhurave të përgjithshme, në këtë periudhë shënon 53.832 milionë denarë, përkatësisht 45.3% të planit vjetor, ndërsa shpenzimet jotatimore dhe kapitale janë realizuar në vlerë prej 2.782 milionë denarë ose 40.0% në raport me të planifikuarat për të gjithë vitin.

Struktura e të ardhurave të realizuara tatimore tregon se tatimi mbi vlerën e shtuar ka pjesëmarrje më të madhe me 24.068 milionë denarë apo 44.7% të të ardhurave të përgjithshme tatimore (Grafiku 9). Mandej vijojnë të ardhurat në bazë të akcizave të arkëtuara me 11.406 milionë denarë, tatimi mbi të ardhurat personale me 8.702 milionë denarë, tatimi mbi fitimin me 6.535 milionë denarë, detyrimet e importit me 2.855 milionë denarë dhe të ardhurat tjera tatimore me 266 milionë denarë.


Grafiku 9. Struktura e të ardhurave tatimore të realizuara, janar - qershor viti 2019



Shpenzimet e përgjithshme të Buxhetit themelor në periudhën janar - qershor të vitit 2019 janë realizuar në vlerë prej 64.424 milionë denarë apo 46.2% nga mjetet e përgjithshme të parashikuara me Buxhetin themelor për vitin 2019.


Në strukturën e shpenzimeve të realizuara në këtë periudhë pjesëmarrje më të madhe kanë shpenzimet në bazë të transfereve rrjedhëse në fondet buxhetore me 17.272 milionë denarë. Mandej vijojnë: pagat, mëditjet dhe kompensimet me 12.788 milionë denarë, subvencionet dhe transferet me 10.041 milionë denarë, shpenzime për transfere rrjedhëse në njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVL) me 9.471 milionë denarë, mallrat dhe shërbimet me 5.219 milionë denarë, beneficione sociale me 4.387 milionë denarë, pagesat e interesit me 2.728 milionë denarë dhe shpenzime kapitale me 2.468 milionë denarë. Në grafikun 10 është paraqitur pjesëmarrja e tyre në përqindje në shpenzimet e përgjithshme.

Grafiku 10. Struktura e shpenzimeve të realizuara sipas klasifikimit ekonomik, janar - qershor viti 2019



Nga mjetet e përgjithshme të planifikuara, për paga dhe kompensime për vitin 2019 me Buxhetin themelor, në periudhën e analizuar janë realizuar 48.2%, ndërsa shkalla e realizimit në kategorinë mallra dhe shërbime është 42.1%. Në grafikun 11 janë paraqitur të dhënat e zbërthyera për shpenzimet e realizuara për mallra dhe shërbime.

Grafiku 11. Shpenzime për mallra dhe shërbime, janar - qershor viti 2019 (në milionë denarë)



Transferet rrjedhëse në fondet buxhetore në gjysmën e parë të vitit paraqesin 51.4% të planit vjetor. Në kuadër të kësaj kategorie, vlera më e lartë, përkatësisht 85.0% i takon transfereve në Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë së Veriut (Fondi i FSPIM), ndërsa pjesa tjetër i përket transfereve në Fondin për sigurim shëndetësor.


Nga mjetet e përgjithshme të planifikuara për transfere rrjedhëse në NJVL për vitin 2019, në gjysmën e parë të vitit janë realizuar 49.5%. Në kuadër të kësaj kategorie, vlera më e lartë, përkatësisht 87.9% në bazë të bllok dotacioneve dhe të dedikuara, ndërsa pjesa tjetër është në bazë të dotacioneve të TVSH-së.

Shkalla e realizimit të kategorisë së subvencioneve dhe transfereve në periudhën e shqyrtuar është 59.6%. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve, përkatësisht 61.6% janë paguar në bazë të subvencioneve bujqësore nga ana e Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural.

Beneficionet sociale në periudhën janar - qershor paraqesin 42.8% të planit vjetor.

Shpenzimet kapitale në periudhën e shqyrtuar paraqesin 21.2% nga mjetet e planifikuara për këtë dedikim me Buxhetin themelor për vitin 2019. Në grafikun 12 janë paraqitur të dhënat e zbërthyera për shpenzimet kapitale të realizuara.

Grafiku 12. Shpenzime kapitale, janar - qershor të vitit 2019 (në milionë denarë)



Në periudhën e shqyrtuar, pagesa e kryegjesë të Buxhetit themelor në bazë të borxhit të përgjithshëm është 8.889 milionë denarë, ndërsa pagesat në bazë të normës së interesit janë 2.728 milionë denarë. Nga daljet e përgjithshme në bazë të pagesës së kredive, 6.116 milionë denarë janë dalje për pagesë të kryegjesë të kreditorëve jorezidencial. Për shpenzime në bazë të normës së interesit ndaj kreditorëve vendor janë paguar 1.171 milionë denarë, ndërsa ndaj kreditorëve të huaj janë paguar 1.557 milionë denarë.

3.1.2 Realizimi i buxhetit të fondeve

Fondi i SPIMV në gjysmën e vitit ka realizuar suficit prej 644 milionë denarë. Realizimi i të ardhurave dhe fluksi i të hyrave duke përfshirë muajin qershor janë 37.562 milionë denarë, që paraqet 51.8% në raport me të planifikuarat për vitin 2019, ndërsa realizimi i shpenzimeve është 36.918 milionë denarë, përkatësisht 50.9% të planit vjetor. Nga të ardhurat e përgjithshme, 19.808 milionë denarë janë të ardhura në bazë të kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor (46.6% të planit vjetor), 14.680 milionë denarë janë transfere nga Buxheti themelor, 631 milionë denarë janë të ardhura të akcizës, ndërsa pjesa tjetër 2.443 milionë denarë janë të ardhura tjera të Fondit.

Në pjesën e shpenzimeve të Fondit të SPIMV, shpenzimet për pensione janë realizuar në vlerë prej 27.963 milionë denarë apo 49.6% nga të parashikuarat për vitin 2019. Pagesa e pensioneve realizohet sipas dinamikës së parashikuar për vitin 2019. Transferet nga Fondi i SPIMV në fondet pensionale private janë 4.899 milionë denarë, ndërsa kontributet për sigurim shëndetësor për pensionerët në Fondin për sigurim shëndetësor janë realizuar në vlerë prej 3.823 milionë denarë. Shpenzimet për paga, mallra dhe shërbime dhe shpenzimet e tjera janë realizuar në vlerë prej 233 milionë denarë.

Duke përfshirë muajin qershor të vitit 2019, Fondi për sigurim shëndetësor ka realizuar deficit në vlerë prej 272 milionë denarë, në kushte të të ardhurave të realizuara prej 15.145 milionë denarë, që paraqesin 49.2% të planit vjetor dhe shpenzime të realizuara prej 15.417 milionë denarë, përkatësisht 50.1% nga të planifikuarat për vitin 2019.

Në periudhën e shqyrtuar, janë realizuar të ardhura nga kontributet për sigurim shëndetësor në vlerë prej 8.369 milionë denarë apo 48.5% të planit vjetor. Kontributet për sigurim shëndetësor të pensionerëve të paguara nga Fondi i SPIMV janë 3.823 milionë denarë, ndërsa kontributet për sigurim shëndetësor të paguara nga Agjencia për punësim të RMV-së janë 76 milionë denarë. Transferet nga Buxheti themelor janë 2.592

milione denarë, të ardhurat nga participimi janë 225 milionë denarë, ndërsa pjesa tjetër e të ardhurave janë 60 milionë denarë. Në pjesën e shpenzimeve janë realizuar shpenzime për mbrojtjen shëndetësore primare prej 13.062 milionë denarë, shpenzimet për pushim mjekësor prej 1.754 milionë denarë, për vegla ndihmëse ortopedike prej 233 milionë denarë dhe për mjekim jashtë vendit prej 135 milionë denarë. Shpenzimet për paga, mallra dhe shërbime, si dhe për shpenzime kapitale janë 233 milionë denarë.

Agjencia për punësim të RMV-së në periudhën janar - qershor të vitit 2019 ka realizuar deficit në vlerë prej 70 milionë denarë, në kushte të të ardhurave të realizuara në vlerë prej 1.319 milionë denarë (45.0% në raport me buxhetin vjetor). Kontributet në bazë të sigurimit në rast të papunësisë janë realizuar në vlerë prej 1.242 milionë denarë dhe paraqesin 48.9% të planit vjetor.

Shpenzimet e Agjencisë për punësim në bazë të kompensimit financiar për personat e pa punësuar në gjysmën e parë të vitit janë 763 milionë denarë, në bazë të mjeteve për punësim të persoave me invaliditet shënojnë 57 milionë denarë, për masa aktive për punësim janë realizuar 292 milionë denarë, ndërsa për pagesë të kontributeve për sigurim pensional dhe shëndetësor për personat e papunësuar janë shpenzuar 76 milionë denarë. Shpenzimet për paga, mallra dhe shërbime të Agjencisë janë 131 milionë denarë.

3.1.3 Realizimi i buxhetit të llogarive personale për të ardhura të shfrytëzuesve buxhetorë

Në pajtim me Buxhetin e RMV-së për vitin 2019 është planifikuar deficit për buxhetet e llogarive personale për të ardhura të shfrytëzuesve buxhetor (të destinuar për aktivitete vetëfinancuese, hua dhe donacione) në vlerë prej 3.842 milionë denarë, ndërsa në periudhën e analizuar është realizuar suficit në vlerë prej 477 milionë denarë.

Duke përfshirë muajin qershor të vitit 2019, të ardhurat e përgjithshme të realizuara të këtyre llogarive shënojnë 6.812 milionë denarë (33.8% të planit për vitin 2019), ndërsa janë realizuar shpenzime në vlerë prej 6.335 milionë denarë (26.4% të buxhetit vjetor). Në kuadër të shpenzimeve, për të ardhura rrjedhëse janë shpenzuar 3.535 milionë denarë apo 36.0% të planit vjetor, ndërsa shpenzime kapitale janë realizuar mjete në vlerë prej 2.800 milionë denarë apo 19.7% të planit vjetor.

3.1.4 Realizimi i Buxhetit të RMV sipas shfrytëzuesve buxhetorë⁵

Në vazhdim është dhënë një pasqyrë e shpenzimeve dhe hyrjeve të Buxhetit të RMV-së për shfrytëzuesit më të mëdhenj buxhetorë, buxheti vjetor i të cilëve paraqet 81.0% të buxhetit të përgjithshëm për të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë (Grafiku 13).

Ministria për punë dhe politikë sociale në gjysmën e parë të vitit 2019 realizoi 21.848 milionë denarë apo 1.0% më shumë në krahasim me vitin e kaluar. Realizimi i shpenzimeve është 49.0% të buxhetit të përgjithshëm për vitin 2019. Përveç kësaj, pjesa më e madhe (71.7%) të shpenzimeve në këtë periudhë janë dedikuar për transfere rrjedhëse në fondet buxhetore, për të cilat janë shpenzuar 15.664 milionë denarë apo 51.8% të mjeteve të dedikuara për vitin 2019. Zëri i dytë më i rëndësishëm i shpenzimeve janë beneficionet sociale, të cilat janë 20.1% në shpenzimet e përgjithshme dhe për këtë dedikim janë realizuar 42.8% (4.386 milionë denarë) nga të planifikuarat për vitin 2019. Realizimi më i dobët i beneficioneve sociale në periudhën e deritanishme pritet që të kompensohet në gjysmën e dytë të vitit, si reflektim i shtesës sociale të rritur në muajin qershor, në përputhje me të drejtat e parashikuara me reformën e re sociale.


Në periudhën janar - qershor të vitit 2019, përmes ndarjes Ministria e financave - funksione të shtetit⁶ janë realizuar 14.544 milionë denarë, përkatësisht 43.5% nga të parashikuarat për vitin 2019. Pagesa e kryegjësë (8.889 milionë denarë) është zëri kryesor në shpenzimet e përgjithshme të këtij shfrytëzuesi buxhetor dhe merr pjesë me 61.1% në të përgjithshmet. Në bazë të pagesave të interesit bien 18.8% të shpenzimeve të

⁵ Të dhënat janë paraprake dhe të pakonsoliduara dhe përfshijnë edhe fluksin e të hyrave dhe të dalave.

⁶ Në kuadër të kësaj ndarje janë përfshirë këto aktivitete: servisi në kohë i detyrimeve të shtetit në bazë të huamarrjes vendore dhe të jashtme; pagesa e rregullt e shpenzimeve operative të shtetit mbi dokumentacionin e pagesave të dorëzuar më parë; pjesëmarrja në kapitalin e institucioneve financiare ndërkombëtare; Pagesa e TVSH-së në investimet kapitale të financuara nga donacionet, financimi i projekteve nga komponentët individualë të IPA-s, etj.

përgjithshme, për të cilat janë realizuar 2.728 milionë denarë apo 30.3% të buxhetit të përgjithshëm për këtë dedikim. Zëri i tretë më i rëndësishëm janë transferet rrjedhëse në NJVL me një pjesëmarrje prej 7.9% për të cilat janë shpenzuar 1.149 milionë denarë.

Grafiku 13. Struktura e shpenzimeve dhe flukseve dalëse sipas shfrytëzuesve buxhetorë, janar - qershor viti 2019



Ministria për arsim dhe shkencë në periudhën janar - qershor të vitit 2019 realizoi mjete buxhetore në vlerë prej 11.297 milionë denarë (43.2% nga e planifikuara), që është për 5.7% më shumë në krahasim me vitin e kaluar. Pjesë më të madhe të shpenzimeve (63.2%) paraqesin transferet rrjedhëse në NJVL, për të cilat janë realizuar 7.137 milionë denarë apo 49.6% të mjeteve të planifikuara. Pagat dhe kompensimet janë zëri i dytë më i rëndësishëm me një pjesëmarrje prej 15.1% për të cilat janë shpenzuar 1.709 milionë denarë, përkatësisht 46.4% nga të parashikuarat e përgjithshme. Për mallra dhe shërbime (të cilat marrin pjesë me 12.5% të shpenzimeve të përgjithshme) janë realizuar 1.408 milionë denarë, që paraqet 33.7% nga mjetet e parashikuara të përgjithshme për vitin aktual.

Në periudhën janar - qershor të vitit 2019, Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural (APFBZHR) realizoi mjete në vlerë prej 5.794 milionë denarë (66.8% të mjeteve të përgjithshme të realizuara për vitin 2019), që paraqet realizim më të ulët në vlerë për 11.3%, në raport me periudhën e njejtë të vitit 2018, si rezultat i dinamikës së ngadalësuar të pagesës së subvencioneve dhe transfereve në gjysmën e parë të vitit 2019 e cila pritet që të përshpejtohet në gjysmën e dytë të vitit.

Në gjysmën e parë të vitit 2019 në Ministrinë e punëve të brendshme gjithsej janë realizuar 5.553 milionë denarë, që paraqet 50.6% të buxhetit për vitin 2019, përkatësisht rritje për 8.4% në raport me vitin paraprak. Zëri buxhetor më i rëndësishëm i shpenzimeve janë pagat dhe kompensimet me një pjesëmarrje prej 70.2%, për të cilat janë shpenzuar 3.900 milionë denarë ose 50.7% nga e planifikuara. Zëri i dytë më i rëndësishëm janë mallrat dhe shërbimet me një pjesëmarrje prej 19.8%, nga të cilat janë realizuar 1.101 milionë denarë, që është 56.2% e planit vjetor.

Ministria e Mbrojtjes në gjysmën e parë të vitit 2019, realizoi mjete buxhetore në vlerë prej 3.409 milionë denarë, që paraqet 41.0% të buxhetit të përgjithshëm këtë vit dhe paraqet rritje prej 32.9% në krahasim me vitin e kaluar, si rezultat i realizimit më të lartë pothuajse nga të gjitha zërat buxhetorë. Pagat dhe kompensimet kanë pjesëmarrje më të madhe të shpenzimeve prej 56.4%, që në periudhën janar - qershor të vitit 2019 u realizuan 1.922 milionë denarë (48.4% të mjeteve të përgjithshme të parashikuara për vitin aktual). Shpenzimet për mallra dhe shërbime përbëjnë 22.1% të shpenzimeve të përgjithshme, për të cilat sa i përket periudhës së analizuar janë shpenzuar 753 milionë denarë ose 38.1% të parashikimeve të përgjithshme.

Ministria e shëndetësisë në gjysmën e parë të vitit realizoi mjete buxhetore në vlerë prej 2.592 milionë denarë (zvogëlim prej 15.5% në krahasim me periudhën e njejtë të vitit paraprak), që është 40.0% të buxhetit të


përgjithshëm për vitin 2019. Transferet rrjedhëse në fondet buxhetore kanë pjesëmarrje më të madhe në shpenzime me 53.1%, për të cilën në periudhën janar - qershor të vitit 2019 janë shpenzuar 1.377 milionë denarë apo 48.0% të mjeteve të dedikuara për vitin 2019. Mallrat dhe shërbimet janë zëri i dytë më i rëndësishëm me pjesëmarrje prej 38.2% në shpenzimet e përgjithshme, ndërsa në periudhën e realizuar për këtë dedikim janë shpenzuar 990 milionë denarë, përkatësisht 43.1% nga të parashikuarat e përgjithshme.

Ministria e transportit dhe lidhjeve në periudhën janar - qershor të vitit 2019 realizoi mjete në vlerë prej 2.120 milionë denarë, që është pothuajse dyfish më shumë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak dhe paraqet 29.1 të buxhetit të përgjithshëm për vitin 2019. Zëri buxhetor me pjesëmarrje më të madhe në shpenzimet e përgjithshme të këtij shfrytëzuesi buxhetor janë shpenzimet kapitale, realizimi i së cilëve në gjysmën e parë të vitit 2019 është 1.633 milionë denarë (77.0% nga shpenzimet e përgjithshme), që është 25.9% të buxhetit të përgjithshëm për këtë dedikim. Në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2018, realizimi i shpenzimeve kapitale është rritur për 2.5 herë ndërsa intensifikim shtesë pritet në gjysmën e dytë të vitit.

3.2. Menaxhimi me borxhin publik

Borxhi shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut në fund të T1 të vitit 2019 është 4.343.0 milionë euro, përkatësisht 38.2% nga BPV-ja për vitin 2019, ndërsa borxhi publik⁷ që përfshin borxhin shtetëror dhe të garantuar është 5.242,3 milionë euro, përkatësisht 46.1% të BPV-së (Grafiku 14). Përveç kësaj, në raport me fundin e vitit 2018, pjesëmarrja e borxhit shtetëror në BPV në fund të T1 të vitit 2019 është më e ulët për 2.3 p.p., ndërsa borxhi publik për 2.4 p.p..


Grafiku 14. Gjendja e borxhit shtetëror dhe publik (në % të BPV-së)



Sa i përket strukturës së normës së interesit të borxhit shtetëror, në fund të T1 të vitit 2019 raporti normës së interesit fiks dhe variable është 77.2:22.8 përkatësisht (Grafiku 15). Nga aspekti i kompozimit valutor, në fund të T1 të vitit 2019, borxhi në valutën vendore merr pjesë me 21.3% në portofolin e borxhit shtetëror të përgjithshëm, shtetëror ndërsa borxhi i shprehur në valutën vendore merr pjesë me 21.3% në portofolin e borxhit të përgjithshëm shtetëror, ndërsa borxhi i shprehur në valutë të huaj merr pjesë me 78.7%. Përveç kësaj, pjesëmarrja e borxhit në euro në borxhin e përgjithshëm shtetëror është 72.5% (duke pëfshirë edhe letrat shtetërore me vlerë në tregun e brendshëm me klauzolë devisorë), të drejtat speciale për tërheqje marrin pjesë me 4.9%, borxhi në jen japonez merr pjesë me 1.0%, ndërsa borxhi i shprehur në dollarë amerikanë merr pjesë 0.2%.

⁷ Ndryshimet e fundit të Ligjit për Borxhet Publik u miratua në maj të vitit 2019 ("Gazeta Zyrtare" nr. 98/2019), dhe me këto ndryshime borxhi jo i garantuar u përfshi në përcaktimin e borxhit publik. Ky raport e paraqet përfshirjen e borxhit në përputhje me legjislacionin në fuqi që nga fundi i tremujorit të parë të vitit 2019.

Grafiku 15. Struktura e interesit (ana e majtë) dhe valutore e borxhit shtetëror në T1 të vitit 2019



Në tregun vendor në periudhën janar - qershor të vitit 2019, Ministria e Financave në bazë të rregullt lëshoi letra shtetërore me vlerë, me theks të veçantë në maturimet më të gjata. Lëshimi i letrave shtetërore me vlerë është në përputhje me Strategjinë e denarizimit me rritje të vazhdueshme përfaqësimit të emetimit të letrave me vlerë në valutë vendore.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2019, u realizuan rishikime të rregullta të vlerësimit të rejtingut kreditor të “Fitch” dhe “Standard & Poor”:

- Në qershor të vitit 2019, “Fitch” e rriti rejtingun kreditor të Republikës së Maqedonisë së Veriut në valutë të huaj dhe vendase, duke e vlerësuar me BB +, me një perspektivë stabile. Përmirësimi i vlerësimit është rezultat i stabilizimit politik dhe përmirësimit të marrëdhënieve kryesore ndërkombëtare, zgjidhjes së mosmarrëveshjes së emrit me Greqinë, nënshkrimit të protokollit të NATO-s në muajin shkurt si dhe përparimit të mëtuqeshëm në hapjen e negociatave për pranimin në BE, të cilat do të mundësojnë siguri më të madhe politike dhe bazën për reforma të qëndrueshme dhe stabilitet makroekonomik. Në raport janë shënuar karakteristikat e mëposhtme pozitive të ekonomisë maqedonase: hapja e negociatave me BE-në, reformat e mëtejshme politike dhe ekonomike, historia e inflacionit të ulët, rritja e qëndrueshme ekonomike dhe stabiliteti financiar, si dhe fakti i shënuar në raportin Doing Business se Maqedonia e Veriut renditet më lartë se BB dhe kategoria e vendeve të BBB, duke reflektuar ekonomi të hapur dhe zona të zhvilluara teknologjike industriale të eksportit, si bazë për një fluks hyrës stabil të investimeve të huaja direkte. Si dobësi e ekonomisë maqedonase, në raport janë rendit këto: tendenca rritëse e borxhit publik, veçanërisht borxhi i garantuar i ndërmarrjeve publike dhe borxhi shtetëror i shprehur në valutë të huaj, si dhe struktura e lartë e papunësisë, megjithëse është hasur rënie e vazhdueshme;
- Në muajin mars të vitit 2019 “Standard & Poor” e konfirmoi vlerësimin e mëparshëm për rejtingun kreditor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për valutën e huaj dhe vendase BB-, njëkohësisht konfirmoi perspektivën stabile të vendit. Konfirmimi për një perspektivë të qëndrueshme pasqyron vlerësimet e Standard & Poor për rreziqet e balancuara midis trajektorës së borxhit publik dhe të ardhurave relativisht modeste nga njëra anë, si dhe perspektivën e favorshme ekonomike të vendit nga ana tjetër. Karakteristikat pozitive të ekonomisë maqedonase të shënuara në raport janë këto: Zgjidhja e mosmarrëveshjes së emrit me Greqinë në janar të vitit 2019, niveli i ulët i borxhit dhe kushtet e favorshme për rritjen ekonomike, zonat e lira ekonomike si gjenerator i rritjes ekonomike, sektori bankar mirë të kapitalizuar dhe fitimprurës. Dobësitë e ekonomisë maqedonase, të shënuara në raport, janë niveli relativisht i ulët i të ardhurave në shtet dhe politika monetare e kufizuar si rezultat i kursit devisor fikse.